



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2020:061553

Datë: 01.10.2020

Numri i dokumentit: 01156744

**PKR. nr. 99/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Krimeve të Rënda,** me Kryetarin e Trupit Gjykses Mustaf Tahiri, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.F., për shkak të veprës penale keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 paragrafi 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.100.A.464-2/2020 të datës 03.07.2020, pas mbajtjes së seancës mbi marrëveshjen për pranimin e fajësisë me 29.09.2020 në prezencë të prokurorit të shtetit Sebahate Sinani, të akuzuarit I.F. dhe mbrojtëses të tij av. Arbnora Shefkiu, të njëjtën ditë shpalli dhe komunikoi ndërsa me datë 01 tetor 2020 përpiloi me shkrim këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I Akuzuari **I.F.**, i lindur me dt. .... në Shkup, nga i ati ..... dhe e ëma ....., e gjinisë ....., me vendbanim në fsh. .... Komuna Shtime, rruga ..... nr....., me numër personal ....., i martuar, prind i gjashtë fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin teknik, i gjendjes së mesme ekonomike.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse në vitin 2019, i pandehuri si pronar i Operatorit Ekonomik “.....” SH.P.K, me seli në fshatin ....., Komuna Shtime me numër të biznesit ..... me vetëdije ka shkelë rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokument të rremë me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik, në atë mënyrë

që me rastin e ofertimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit në projektin “Sanimi i rrëshqitzes në rrugën Hani i Elezit- Gorancë”, me numër të prokurimit 205-19-5574-5-1-1 dhe numër të brendshëm ..... , ka ofruar të dhëna të rreme, përkatësisht ka falsifikuar formularin e deklaramit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave të ATK-së për vitin 2018, ashtu që në formularin e vitit 2016 ka ndryshuar numrin 6 duke e bërë 8, pra viti 2018.

- me të cilën ka kryer veprën penale keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë dhe neneve 4, 6,7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69 dhe 79 par.2 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, të akuzuarin I.F. e

## G J Y K O N

**DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 180 ditësh i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit e konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1,000 (një mijë) euro, si dhe

**DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 500 (pesëqind) euro.

Konform nenit 76 par.4 të KPRK-së, të pandehurit I.F. gjykata i shqipton **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej 1,500 (një mijë e pesëqind) euro, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 43 par. 3 të KPRK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 (njëzet) Euro do të vuaj nga një ditë burgimi.

Konform nenit 415 par.4 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet ndalesa e marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik në Republikën e Kosovës në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, e në të cilin dënim plotësues konform nenit 79 par.3 të KPRK-së do të llogaritet ndalesa për pjesëmarrje në aktivitete të prokurimit publik në Republikën e Kosovës nga data 19.11.2019 e deri më datë 18.05.2020 e shqiptuar me vendimin PSH.nr.1150/19 i dt.19.11.2019 të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit – Paneli Shqyrtues i Prokurimit.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30/tridhjetë/€, si dhe shumën prej 50/pesëdhjetë/€ për fondin për

**Kompensimin e Viktimave të Krimit, të cilat janë të obliguar që t'i paguajnë në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.**

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku procedural**

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktakuzën PP/I.nr.100.A.464-2/2020 të datës 03.07.2020, ka ngarkuar të akuzuarin I.F. për veprën penale Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj me datë 03.07.2020 së bashku me aktakuzën ka pranuar edhe marrëveshjen për pranimin e fajësisë e nënshkruar nga ana e të pandehurit I.F., mbrojtësi i tij av.Arbnora Shefkriu, prokurori i shtetit Sebahate Sinani dhe kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj Shukri Jashari.

Kryetari i trupit gjykues duke vepruar sipas kësaj akuze ka mbajtur seancën e shqyrtimit të marrëveshjes me datë 15.09.2020, mirëpo pas shqyrtimit të kësaj marrëveshje nga ana e gjykatës, palët përkatësisht i akuzuar dhe mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit janë obliguar që ta përmirësojnë dhe të plotësojnë marrëveshjen për pranimin e fajësisë sa i përket dënimit të rekomanduar dhe dënimit plotësues të paraparë me nenin 415 par.4 të KPRK-së.

Me datë 29.09.2020, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore dhe pas plotësimit dhe përmirësimit të marrëveshje për pranimin e fajësisë, në seancën dëgjimore për pranimin e fajësisë palët janë deklaruar përkitazi me këtë marrëveshje, ku i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit u deklaruan lidhur me marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke i propozuar Gjykatës pranimin e saj sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen për pranimin e fajësisë se datës 28.09.2020.

### **2. Vlerësimi i marrëveshjes së pranimit të fajësisë**

Gjatë shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 233 par. 18 të KPP-ës:

- i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;

- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranoj fajësinë;

- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara nga prokurori dhe atë nga mbrojtja e të akuzuarit dhënë gjatë procedurës hetimore, kallëzim penal i dt.26.02.2020, raporti fillestar i incidentit, Raporti i oficerit i dt.26.02.2020, procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit i dt.25.02.2020 dhe ai i datës 03.07.2020 gjatë zhvillimit të procedurës hetimore, kopjet e Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesën për tatimin në të ardhurat e korporatave e viteve 2016, 2017, 2018, vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit PSH.nr.1150/19 i dt.19.11.2019, të gjitha këto prova të siguruara gjatë procedurës hetimore;

- si dhe nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara me nenin 253 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj, me aktvendim pranoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe bazuar në këtë marrëveshje vazhdoi me shqiptimin e dënimit.

### **3. Vlerësimi ligjor i veprimeve të pandehurit.**

Duke vlerësuar në aspektin juridik Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit I.F. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik nga neni 415 par. 1 të KPRK-së, meqë me datë, kohë dhe vend siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i akuzuari me vetëdije ka shkelë rregullat e prokurimit publik gjatë një oferte për dhënien e kontratës së prokurimit publik, duke paraqitur dokument të rremë me qëllim të mashtrimit në procedurat e prokurimit publik, në atë mënyrë që me rastin e ofertimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit në projektin “Sanimi i rrëshqitjes në rrugën Hani i Elezit- Gorancë”, me numër të prokurimit 205-19-5574-5-1-1 dhe numër të brendshëm MIT 1906451, ka ofruar të dhëna të rreme, përkatësisht ka falsifikuar formularin e deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave të ATK-së për vitin 2018, ashtu që në formularin e vitit 2016 ka ndryshuar numrin 6 duke e bërë 8, pra viti 2018.

### **4. Vlerësimi për dënimin e shqiptuar**

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës dhe gjeti se si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë përmes marrëveshjes për pranim fajësie, pendimin e shprehur lidhur me kryerjen e veprës penale, se është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin , premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale , andaj edhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i përcaktuar me nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 79 par.3 të KPRK-së, në ndalesën në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve të marrjes pjesë në procedurat për dhënien e kontratave në prokurim publik në Republikën e Kosovës, i është llogaritur ndalesa për pjesëmarrje në aktivitete të prokurimit publik në Republikën e Kosovës nga data 19.11.2019 e deri më datë 18.05.2020 e shqiptuar me vendimin PSH.nr.1150/19 i dt.19.11.2019 të lëshuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit – Paneli Shqyrtues i Prokurimit.

### **5. Shpenzimet procedurale**

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në nenin 450 par. 2 pika 6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 39 par. 3 nënpar. 3.2 të LKVK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR. nr. 99/20, me 01 tetor 2020.**

**Asistenti,**

**Kryetari i trupit gjykues,**

**Muedin Rexhepi**

**Mustaf Tahiri.**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.

Numri i lëndës: 2020:061553  
Datë: 01.10.2020  
Numri i dokumentit: 01156744